

Epërme/Gornja Lapaštica, ndërkaq Bajrami drejt *Tabeve të Llapashticës [Llapashticë e Poshtme/Donja Lapaštica]*. I tha të birit që së shpejti do të nisej pas tij. Pas katër ditësh, Misioni i OSBE-së e ka gjetur trupin e Bajramit pranë shtëpisë së tij. E kishin qëlluar me nëntë plumba. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur Bajramin në varrezat e Llapashticës së Poshtme/Donja Lapaštica.

Burimet: deklarata S.M, FDH-13631; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Ajvaz (Rrahim) Potera

(17.04.1951, shqiptar nga Llapashtica e Poshtme/Donja Lapaštica, komuna e Podujevës/Podujevo, i pamartuar)

Ajvazi vuante nga problemet psikike dhe për të kujdesej i vëllai i madh Sadiku. Në datën **24.12.1998**, për shkak të luftimeve mes forcave të UÇK-së dhe atyre serbe, në vendin e quajtur *Tabet e Llapashticës [Llapashticë e Poshtme/Donja Lapaštica]*, Sadiku me familjarët e vet e kanë braktisur fshatin, ndërkaq Ajvazi ndenji në shtëpi. Dy ditë më vonë, Sadiku ka mësuar nga ushtarët e UÇK-së se Ajvazin e kishin vrarë me pushkë snajperi më 24.12.1998, në afërsi të shtëpisë së fqinjit të tyre, dhe se trupi i tij gjendej në xhami. Sadiku e ka varrosur Ajvazin më 27.12.1998 në varrezat e Llapashticës së Epërme/Gornja Lapaštica.

Burimi: deklarata S.P, FDH-12504.

Isa (Arif) Havolli

(17.11.1943, shqiptar nga Llapashtica e Epërme/Gornja Lapaštica, komuna e Podujevës/Podujevo, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Isa ka jetuar në Shkup [Maqedoni] deri në vitin 1989. Pastaj u kthye në fshatin e lindjes së Llapashticës së Epërme/Gornja Lapaštica. Aderoi në UÇK menjëherë pasi ajo filloi me aktivitetet e saj. Në mëngjesin e datës **24.12.1998**, Isa mori pjesë në luftimet me forcat serbe në vendin e quajtur *Tabet e Llapashticës [Llapashticë e Poshtme/Donja Lapaštica]*. Ka ranë në betejë, në mes të orës 9:00 dhe 11:00. Trupin e tij e kanë marrë me vete pjesëtarët të forcave serbe. E bartën në spitalin e

Prishtinës/Priština. E kanë varrosur më 27.12.1998 në varrezat e Llapashticës së Poshtme/Donja Lapaštica.

Burimet: SMIP, *Teroristički...*, III, 582; KKM-KRFJ, *Personat...*, FDH-10832; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHFDUÇK, *Feniksët...*, 9, 129-133.

Albana (Safet) Hajdari

(30.03.1993, shqiptare nga Podujeva/Podujevo)

Forcat e mëdha ushtarake e policore serbe kanë arritur në **Podujevë/Podujevo** më 20.12.1998. U përqendruan në hyrje të qytetit, në afërsi të tjugullores, në vendin e quajtur *Tabet e Llapashticës*. Në datën **24.12.1998**, nga ora 8:30, ato filluan t'i bombardonin fshatrat përreth. Familja e Safetit u mbyll në shtëpi. Luftimet ndërmjet forcave të UÇK-së dhe atyre serbe zgjatën deri në ora 15:00. Pasi pushuan të shtëna, të rriturit dhe fëmijët dolën nga shtëpia. Albana, i vëllai dhe motra e vogël u ngjitën shkallëve për të lozur në katin e dytë të shtëpisë. Përderisa ishin ende në shkallët, një plumb e ka thyer xhamin duke e qëlluar Albanen në kokë. Ka mbetur e vdekur në vend. Familjarët e kanë varrosur Albanën një ditë më vonë në varrezat e Podujevës/Podujevo.

Burimet: deklarata S.H, FDH-12556; deklarata S.H, FDH-3625; SMIP, *Teroristički...*, III, 582; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KKM-KRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Shefkije (Sheqir Kodraliu)

Salihu

(15.08.1958, shqiptare nga Podujeva/Podujevo, amvise, pesë fëmijë)

Shefkija me bashkëshortin Latifin, pesë fëmijë të tyre dhe nënën dhe vëllezërit të bashkëshortit jetonin në shtëpinë e përbashkët në afërsi të tjugullores në Podujevë/Podujevo.

Kur në mëngjesin e datës **24.12.1998**, filluan të dëgjoreshin të shtëna në fshat, Shefkija me vajzat e saj, vjehrrën dhe vëllezërit e bashkëshortit gjendej në shtëpi. Latifi kishte shkuar më herët me punë në Prishtinë/Priština, ndërkaq djali në shkollë në fshatin fqinj të Llapashticës